



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 635 Prot.

Tiranë, më 10.052017

VENDIM Nr. 74, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi Konceptin e Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit, në kuadër të **Projektit Hidroenergjitik të Devollit- HEC Moglicë, SITI Nr. 9**, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Ali,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit, në kuadër të **Projektit Hidroenergjitik të Devollit- HEC Moglicë, SITI Nr. 9**, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Ali.
2. Të plotësohet grupi i punës me stafin e nevojshëm teknik, në përputhje me "Rregulloren mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut; kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte privatë", miratuar me Vendimin Nr. 2, dt. 30.01.2009 të KKA.
3. Subjekti "Devoll Hydropower" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjektin e licencuar në arkeologji, e cili do të kryejë Gërmimin Arkeologjik të Shpëtimit në kuadër të Projektit Hidroenergjitik të Devollit- HEC Moglicë, SITI Nr. 9, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO